



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 077/17
Prishtinë, më 25 qershor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 25 QERSHOR 2009**

Seancën e drejtoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 66 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23 Qershor 2009 vendosi që Kuvendit t'i propozojë për seancën e sotme plenare të radhitet edhe – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre.

Kryetari i ftoi deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë absolute, miratoi propozimin që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Lizingun Financiar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore,
7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat sendore,
8. Shqyrtim i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike,
9. Shqyrtim i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008, dhe
10. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e zv. drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj Agjencie,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 28, 29 maj dhe 11 e 18 qershor 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e seancave plenare të mbajtura më 28, 29 maj dhe 11 e 18 qershor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja, Suzana Noveoberdaliu, parashtroi pyetje për Kryeministrin , Hashim Thaqi, lidhur me politikat e deritanishme karshi shëndetit të qytetarëve të Kosovës.

Për shkak të mungesës së kryeministrit Thaqi, deputetja Novoberdaliu nuk mori përgjigjeje.

Deputeti, Riza Smaka, parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me rritjet e vetëvrasjeve në vendin tonë.

Për shkak të mungesës së ministrit Pajaziti, deputeti Smaka nuk mori përgjigjeje.

Deputeti, Riza Smaka, parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me mbajtjen e armëve të zjarra pa leje zyrtare.

Për shkak të mungesës së ministrit Pajaziti, deputeti Smaka nuk mori përgjigjeje.

Deputeti, Riza Smaka, parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, lidhur me mos përfilljen e kontratave për privatizimin e pronave shoqërore.

Për shkak të mungesës së ministrit Shala, deputeti Smaka nuk mori përgjigjeje.

Deputeti, Naim Rustemi, parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, lidhur me respektimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Për shkak të mungesës së ministrit Shala, deputeti Rustemi nuk mori përgjigjeje.

Deputetja, Myrvete Pantina, i parashtoi pyetje ministrit të Kulturës, Rinis dhe Sporteve, Valton Beqiri, lidhur me monumentet historike kulturore.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti, Naim Rustemi, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaqi, lidhur me funksionimin e jetës demokratike në Kosovë.

Për shkak të mungesës së Kryeministrit Thaqi, deputeti Rustemi nuk mori përgjigjeje.

Deputetja, Gjylnaze Syla, parashtoi pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiç, lidhur me procedimin e projektligjit për punën për shqyrtim në Kuvend.

Ministri Rashiç iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja, Luljeta Shehu, i parashtoi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiç, lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve me spinov special dhe spinov të rregullt.

Ministri Rashiç iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputeti, Dritan Tali, i parashtoi pyetje ministrit të Kulturës, Rinis dhe Sporteve, Valton Beqir, lidhur me Federatat e sportit të Kosovës dhe të Shqipërisë për integrim.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja, Nurishahe Hulaj, i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve nga fusha e shëndetësisë.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputeti, Riza Smaka, parashtoi pyetje për ministrin e Bujqësis, Pylltaris dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me përputhjen e dispozitës së nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-016 për Ushqimin.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti, Riza Smaka, parashtroi pyetje për zëvendës kryeministrin, Hajredin Kuqi, lidhur me shkallen e ulët të besimit të qytetarëve kosovarë në institucionet publike vendore.

Për shkak të mungesës së zëvendës kryeministrit Kuqi, deputeti Smaka nuk mori përgjigjeje.

Deputeti, Riza Smaka, parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinis dhe Sporteve, Valton Beqiri, lidhur me cenimin e të drejtave të autorit në vendin tonë.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës

Kryetari, ftoi përfaqësuesin e Qeveris së Kosovës që ta prezantoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.

Ministri, **Idriz Vehapi** tha se për shkak të nevojës se ndryshimit të këtij ligji i rekomandoi Kuvendit ta miratoi në parim këtë Projektligj.

Kryetari, ftoi kryetarin e komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe planifikim hapësinor që ta merr fjalën.

Nga Komisioni funksional nuk pati të paraqitur për fjalë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Eset Cakolli, , në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, si dhe deputetët: Armend Zemaj, Rasim Selmani, Riza Smaka, Ramadan Avdiu, Ardian Gjini, Njomza Emini, Elheme Etemi, Gani Buqinca, të cilët janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural **Idriz Vehapi** tha se, si qytetarë i Kosovës jam i shqetësuar për gjendjen e pyjeve në Kosovë, por si ministër jam për gjegjes për mbrojtjen e tyre. Vetëm gjatë këtij viti janë ngritur rreth dhjetë mijë padi për dëmtimin e pyjeve, gjendja e pyjeve në krahasim me vitet e kaluara është me e mirë, me gjithë se Ligji ka qenë i zbatueshëm duhet të behet ndryshimi i tij pasi që përgjegjësit e Komunave duhet të definojnë.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----3,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, **Myzejene Selmani** tha se komisioni ka propozuar amendamentet e Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovës dhe i propozojmë kuvendit për miratim

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, energjetik, Transport dhe Telekomunikacion .

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe18.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për54,
Kundër.....0,
Abstenime.....3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Lizingun Financiar

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjit për Lizingun Financiar dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari e Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore dhe Komisioni një zëri i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa .

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, dhe 27.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për58,
Kundër.....0,
Abstenime.....5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Lizingun.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni ka propozuar amendamentet e këtij Projektligji i cili departament kalon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe këtë Projektligj së bashku me amendamentet e propozuara i rekomandojmë Kuvendit për miratim.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për55,
Kundër.....0,
Abstenime.....4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Departamentin e Mjekësis Ligjore.

7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat sendore

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 30 korrik 2008 dhe mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin e ligjeve të pa shpallura, Komisioni përgjegjës raportues, ka shqyrtuar tekstin e Ligjit për të drejtat sendore dhe Kuvendit i ka parashtruar Rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim

Kryetari e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se si Komisionin funksional, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit për ri-procedimin e ligjeve të pa shpallura nga PSSP-ja ka caktuar grupin punës për shqyrtimin e këtij Ligji dhe Komisioni pas shqyrtimit të raportit të grupit punës të këtij ligji i propozon amendamentet e nevojshme dhe Kuvendit i propozon miratimin e këtij Ligji me amendamentet e propozuara.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8 dhe 9.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për52,
Kundër.....5,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për pronësinë dhe të drejtat sendore.

8. Shqyrtim i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike

Kryetari, i njoftoi deputetet se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare me rekomandimet e paraqitura në raport.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi **Bahri Hyseni** tha se, Komisioni e ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2008 dhe Kuvendit i ka dorëzuar për shqyrtim dhe miratim me rekomandimet e propozuara.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Xhynaze Sylja, Riza Smaka, të cilët janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari hodhi në votim Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2008 me Rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për57,
Kundër.....4,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2008 me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

9. Shqyrtim i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008

Kryetari, i njoftoi deputetet se Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare me rekomandimet e paraqitura në raport.

Në emër të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media **Esat Brajshori** tha se si komision funksional dhe referues, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2009, vendosi që për Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008 Kuvendi i paraqet për shqyrtim dhe miratim me vërejtjet e dhëna në Raport.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anita Morina-Saraçi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, Mursel Halili si dhe deputetët: Xhylnaze Syla, Myzejene Selmani, Hajdin Abazi, Naser Rugova, Adem Salihaj, Hydajet Hyseni, Bahri Hyseni, Esat Brajshori, të cilët janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi

Kryetari hodhi në votim Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për43,
Kundër.....13,
Abstenime.....3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008.

10. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e zv. drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj Agjencie

Kryetari, i njoftoi deputetet se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka shqyrtuar Propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e zv/drejtorit të sekretarisë ekzekutive të Agjencisë së Pronave dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi **Bahri Hyseni** tha se Komisioni duke u bazuar në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e zëvendës drejtorin dhe dy anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronave, Kuvendit i paraqet për shqyrtim dhe miratim propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e zëvendës drejtorit dhe dy anëtarëve të Agjencionit Kosovar të Pronave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, Bojan Stojanoviç si dhe deputeti: Bahri Hyseni, të cilët janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e zv/drejtorit të sekretarisë ekzekutive të Agjencisë së Pronave . Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për23,
Kundër.....35,
Abstenime.....2.

Kryetari hodhi në votim propozim-vendimin e Qeveris për emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Pronave . Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për11,
Kundër.....42,
Abstenime.....4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk miratoi Propozim-vendimin e Qeveris së Kosovës për emërimin e zv/drejtorit të sekretarisë ekzekutive të Agjencisë së Pronave dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Propozim-vendimin e Qeveris së Republikës së Kosovës për emërimin e zëvendës-drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronave dhe dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie .

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, tha se Komisioni funksional ka shqyrtuar amendamente e propozuara nga grupi punues dhe ka miratuar këto amendamente për Projektligjin për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratoi Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, **Myzejene Selmani**, si dhe deputetët **Ardian Gjini** dhe **Gani Koci** të cilët janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, dhe 31.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për52,
Kundër.....7,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për partneritetet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:48 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**